

Departamenti i Prokurimit

LIPJAN: datë, 21.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 2) të Ligjit për Prokurimit Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 6 (paragrafi 6.1) të Rregullave për Parashtrim të Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.12.2020, të parashtruar nga Operatorët Ekonomik NPT "Artatex"—Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me dezinfektues 500 ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore" me nr. të Prokurimit 613-20-5228-1-2-1, nxjerr:

VENDIM

- I. Refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE NPT "Artatex"—Pejë e datës 18.12.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me dezinfektues 500 ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore**, me nr. të prok: **613-20-5228-1-2-1**
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos të vazhdoi me aktivitetin e prokurimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët e interesuara në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsyetim

OE NPT "Artatex"—Pejë, më datë 18.12.2020, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi me dezinfektues 500 ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore"** me Nr. të Prok: **613-20-5228-1-2-1**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 21.12.2020 ka shqyrtuar kërkesën e juaj dhe ka konstatuar se kërkesa juaj është e pabazuar

Me rastin e Ri-Vlerësimit të tenderëve, edhe Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes, sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë, por që nuk ishte i suksesshëm, ngase nuk ishte me çmim më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe në dosje të tenderit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Adem Duriqi
Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit